



DOGANA E KOSOVËS - CARINA KOSOVA - KOSOVO CUSTOMS

19.11.2020

DALJE - IZLAZ - PASSING

No.Dr.Na

01/960/2020

Drejtori i Ardhurave - Uprava Uprava - Central Administration

Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Financave
Ministarstvo za Finansije - Ministry of Finance



Dogana e Kosovës - Carina Kosova - Kosovo Customs
(Drejtori i Përgjithshëm)

DOGANA E KOSOVËS

01

19.11.2020

PRISHTINË

Në mbështetje të nenit 6 paragrafi 8 pika g) të Kodit Doganor dhe të Akcizave Nr. 03/L-109, dhe konkluzioneve të tryezës lidhur me çështjet e zbatimit të Ligjit 06/L0-11 Për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik, Drejtori i Përgjithshëm i Doganës së Kosovës sjellë këtë:

V E N D I M

Për themelimin e Autoritetit Përgjegjës në Doganën e Kosovës për të trajtuar rastet e konfliktit të interesit në burim – si shkallë e parë.

1. SHFUQIZOHET – vendimi 01/235 i dt. 03.03.2020.
2. CAKTOHET - Gyltene Sylja – Udhëheqëse e sektorit të Standardeve Profesionale si zyrtare përgjegjëse për trajtimin e rasteve të konfliktit të interesit në Doganën e Kosovës.
3. OBLIGOHET - Autoriteti Përgjegjës të ndërmarrin veprime në zbatim të parimeve, rregullave dhe procedurat e parapara me ligjin e veçantë për parandalimin, identifikimin, menaxhimin dhe trajtimin e rasteve të konfliktit të interesit në Doganën e Kosovës.

Drejtorja e Doganës, Lagjja Kalabri, Rr. Rexhep Krasniqi 10.000 Prishtinë, Republika e Kosovës

Tel & Fax (++ 381 38) 540 350 / 540 836

www.dogana-ks.org

4. Të dorëzojnë Agjencisë çdo vit për vitin pararendës, por jo më vonë se data 31 janar, një raport për veprimtarinë e kryer në zbatim të këtij ligji, përfshirë rastet e konfliktit të interesave, mënyrat e ndjekura për parandalimin ose trajtimin e tyre, rezultatet e arritura, si dhe statusin e trajtimit të tyre.
5. Detyrat dhe përgjegjësitë tjera të Autoritetit Përgjegjës do të caktohen me përshkrim të detyrave.

ARSYETIM

Drejtori i Përgjithshëm i Doganës së Kosovës, në mbështetje të nenit 6 paragrafi 8 pika g) të Kodit Doganor dhe të Akcizave Nr. 03/L-109, dhe konkluzioneve të tryezës të anëtarëve të panelit nga institucionet e zbatimit të ligjit lidhur me çështjet e zbatimit të Ligjit 06/L0-11 Për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik, mbajtur me datë 21 janar 2020, Prishtinë.

Me qëllim të garantimit dhe kryerjes së detyrave publike në mënyrë objektive, të paanshme dhe transparente në shërbim të interesit publik nëpërmjet identifikimit, parandalimit, menaxhimit dhe zgjidhjes së konfliktit të interesave të zyrtarëve, Drejtori i Përgjithshëm i Doganave të Kosovës vendosi të themeloj Autoritetin Përgjegjës për trajtimin e rasteve të konfliktit të interesit në burim – si shkallë e parë në kuadër të Doganës së Kosovës.

Ky vendim hynë në fuqi me ditën e nënshkrimit të tij nga Drejtori i Përgjithshëm i Doganës së Kosovës.

u.d. Drejtor i Përgjithshëm i Doganës së Kosovës

Bajram REXHA

Të njoftohen:

- Zyrtari Përgjegjës;
- Burimet Njerëzore;
- Arkivi i ZDP-së;
- Agjencia Kundër Korrupsionit

